



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2022/ 2 prot.,

Datë 22.08.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Tenius Laboratories” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-69124-05-11-2023, me objekt: “Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore (për impiantin)”, me fond limit 3,000,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 12.05.2023 nga autoriteti kontraktor, ECO-ELB sh.a

Ankimues: “Tenius Laboratories” SHPK
Rruga dytesore Maminas-Vore , Nr 20/38, Koxhas, Durrës

Autoriteti Kontraktor: ECO-ELB sh.a
Lagja “Brigada 17 Sulmuese”, bulevardi “Qemal Stafa”

Në datën 18.08.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3368 dhe me nr. 2022/2023 prot., datë 21.08.2023 e operatorit ekonomik “Tenius Laboratories” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Tenius Laboratories” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti

kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Tenius Laboratories” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik “TENUIS” nuk permbush kriterin 2.3.4 të DST.

2.3.4 Operatori Ekonomik, duhet të disponojë të paktën 2 (dy) mjete në pronësi ose me qira për të bërë të mundur lëvizjene instrumenteve dhe pajisjeve laboratorike, për realizimin e projektit.

- Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit leja e qarkullimit: certifikatë kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.*
- Për mjetet që janë me qira krahas dokumentit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.*

OE nuk ka paraqitur Certifikatën e kontrollit teknik për mjetin AA 236 IT.

Operatori ekonomik “TENUIS” nuk permbush kriterin 2.3.11 të DST.

2.3.11 Operatori Ekonomik, duhet të ketë laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve urbane si, letra, karton etj.

Laboratori nuk është i Akredituar sipas ISO/IEC 17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve urbane si, letra, karton etj.

Oferta e Operatori ekonomik “TENUIS” ka paraqitur oferte anomalisht të ulët përllëgoaritur sipas Pikes 22 të DST “Vlerësimi i ofertave dhe korigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta”

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Sa me sipër, operatori ekonomik “TENUIS” sh.p.k. nuk kualifikohet”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 22.08.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri